



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:075251
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05439469

E.nr.670/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarimit të kreditorit A.R., të cilët i përfaqëson Av. Samir Rekaj nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shumës në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të ushqimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 12/03/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën E.nr.670/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.670/23, të datës 08/05/2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor: 2022:075252, të datës 27.12.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 01/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 4,554.25 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.670/23, më datë 12.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi